

KQZ  
U PROTOKOLLUA  
NR. 270/PROT  
DATE 15.6.2012

## RAPORTI I AUDITIMIT VJETOR PER VITIN 2021 PER PARTINE LEVIZJA PER NDRYSHIM.

### **I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

#### **A. INFORMACIONI LIGJOR**

i. Kuadri ligjor

Bazuar ne Ligjin Per Partite Politike Nr.8580 date 17/02/2000 i ndryshuar me ligjin nr. 10374 date 10/02/2011, ligjin nr. 17/2014 date 20/02/2014 ligjin nr. 25/2014, date 25/09/2014, ligjin nr. 90/2017

Ligji 10019 date 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise" i ndryshuar

Ligji Nr.10091 date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor Organizimin e profesionit te Audituesit Ligjor dhe Kontablit te te Miratuar, i ndryshuar me Ligjin 10297 date 08/07/2010.

Ligji Nr.9228 date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare"

Gjithe dokumentacioni ligjor i marre prane Partise Levizja per Ndryshim

ii. Standartet e kontabilitetit të zbatueshme

Standartet Kombetare te Kontabilitetit qe perdoren ne Shqiperi

Standardi Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat jo Fitimpruresë(SKK për OJF-të)

#### **B. OBJEKTI I AUDITIMIT**

i. Kontrata e shërbimit

Kontrata e shërbimit Nr.2334.Prot date 09/05/2022,lidhur me KQZ-ne.

ii. Vendimi i KQZ-së

Vendim Nr.150 datë 26.04.2022.



iii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor

Përgjegjësitë e subjektit zgjedhor:

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare të Kontabilitetit.

Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm mbi paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatshme kontabël, dhe kryerjen e cmuarjeve kontabël të asyeshme për rrethanat.

Përgjegjësitë e audituesit ligjor:

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tone. Auditimi jone u bë në përputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit të audituesit duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve për anomali në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Ne berjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm përkatës të entitetit në përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të hartojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat por jo për qëllimin e shprehjes së opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit të audituesit duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve për anomali në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Auditimi, gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmerisë së metodave kontabël të përdorura dhe llogjikën e cmuarjeve kontabël të bera nga drejtimi si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrat financiare. Ne, besojmë që evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tone të auditimit.

**C. PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR TEK AUDITUESI LIGJOR**



i. Prezantimi i subjektit zgjedhor

Partia Levizja per Ndryshim eshte regjistruar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimin Nr.5 date 23/11/2020.  
( Nr 915 Regjistri Themeltar ,date regjistrimi 12/11/2020 ).

Kryetare e Partise eshte Znj. Jozefina Topalli ne cilesine e perfaqesueses politike te " Levizjes per Ndryshim.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit nr.8580,date 17.02.2000 "Per Partite Politike"

ii. Forma e organizimit dhe menaxhimit (qendra dhe degjet rajonale): numri i anëtarëve, struktura dhe numri i degëve në qark dhe organizatat që kanë lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me partinë (për shembull, fondacionet, organizatat e rinisë, etj.)

Partia Levizja per Ndryshim ka vetem seline qendrore ne Tirane me adrese Rruga " Lidhja e Prizrenit " Nr. 8 Tirane.

**D. PREZANTIMI I RAPORTI DHE STRUKTURAT E TIJ**

i. Struktura e raportit të auditimit – kërkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet.

Struktura e raportit te auditimit perbehet nga:

Kërkesa formale ku jepet nje pasqyrim i pergjithshem i pasqyrave financiare ne datën e dorëzimit dhe te nënshkrimit tësaj , te auditit, te aktiveve dhe detyrimeve te Partisë no datën 31.12.2021.

Të ardhurat e Partisë te realizuara gjate periudhes 01.01.2021 deri no 31.12.2021 si dhe nje informacion me i plote per burimin e ketyre te ardhurave.

Te shpenzimeve te kryera nga Partia gjate periudhes një vjecare që fillon nga 01.01.2021 deri no 31.12.2021 se bashku me analizën perkatese to tyre sipas llojit te shpenzimeve dhe perkatesise.

Një sintheze ku permbledhen te gjitha gjetjet gjate procesit te auditimit dhe dhënia e opinionit te çertifikimit.



- ii. Përmenden takimet dhe komunikimet e mundëshme midis audituesit dhe subjektit zgjedhor dhe çdo personi tjetër të tretë.

Me lidhjen e kontrates se shërbimit me KQZ-ne ,u paraqitem prane selise se Partise Levizja per Ndryshim me dt 17/05/2022 dhe kontaktuam me financieren e partise Znj. Liljana Mlloja.

Auditimi eshte kryer pasi Znj.Liljana Mlloja na siguroi dokumentacionin per raportimin financiar vjetor te partise Levizja per Ndryshim per vitin 2021.

Znj.Liljana Mlloja eshte personi pergjegjes per kontabilitetin dhe nuk pati mangesi ne dhenien e dokumentacionit.

- iii. Jepet një paraqitje e përgjithshme në lidhje me raportin vjetor të partisë politike: nëse është ose jo në përputhje me kërkesat e raportimit.

Pasqyra financiare janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat jo Fitimprurese(SKK për OJF-të), dhe me kërkesat e ligjit "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara të kontabilitetit. Mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, elementët njihen si aktive, detyrime, aktive neto, të ardhura apo shpenzime kur ato plotësojnë përkufizimet dhe kriteret e njohjes për këto zëra.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci , zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit .



## II. KËRKESAT FORMALE

### A. PËRMBLEDHJE

1/ Data e dorëzimit të raportit vjetor			
	Dorëzimi fizik	PO	23/03/2022
2/ Nënshkrimi			
	Nënshkrimi	PO	15/03/2022
	Identiteti i nënshkruesit	Po	Liljana Mlloja

### B. CAKTIMI I AUDITUESIT LIGJOR DHE LLOGARISË BANKARE

1/ Informacioni për parti të politike		
	Emri i partisë politike	Levizja per Ndyshim
	Adresa e selisë qendrore	RRUGA " LIDHJA E PRIZRENIT " NR.8 ,TIRANE
	Numri i telefonit të selisë qendrore	
	Adresa e e-mailit të selisë qendrore të partisë (nëse ka)	
2/ Informacion për audituesin ligjor		
	Emri i audituesit ligjor të caktuar	Silvana Gjokdhima
	Adresa e audituesit ligjor	Rr Besnik Sykja, Nd.13, H.4, Ap.5



	Numri i telefonit të audituesit ligjor	0682156357
	Adresa e e-mailit të audituesit ligjor (nëse ka)	silvagjikhima@yahoo.com
<b>3/ Të dhënat e llogarisë bankare të partisë politike</b>		
	Emri i bankës ku mbahet llogaria	BKT
	Adresa e zyrës së bankës ku mbahet llogaria	Dega Kristal, Ruga Fran Bardhi Kristal, Tirane
	Numri i telefonit të zyrës së bankës	
	Adresa e e-mailit të zyrës së bankës apo zyrtarit përgjegjës të bankës	info@bkt.com.al
	Numri i llogarisë bankare	IBAN AL2620511667006478CLOTCLALLR
	Emrat dhe nënshkrimi i të gjithë personave të autorizuar për veprimet tek llogaria bankare	Liljana Mlloja

### C. AKTIVET DHE DETYRIMET

<b>1/ Kriteret e klasifikimit të aktiveve</b>		
	Përshkruani natyrën e secilit aktiv, pronë e partisë, në datën e vlerësimit	<b>S'KA</b>
	Përshkruani vendndodhjen e aktivit	
	Shkruani vlerën e tregut të aktivit, në datën e vlerësimit nëse është bërë vlerësim, ose vlerën kontabël të mbetur	
<b>2/ Kriteret e klasifikimit të detyrimeve</b>		
	Përshkruani llojin e secilit detyrim të partisë, në datën e vlerësimit	<b>S'KA</b>
	Shkruani emrin e kreditorit për detyrimet	
	Shkruani vlerën e detyrimit në datën e vlerësimit dhe kushtet e shlyerjeve	



#### D. PËRMBLEDHJE FINANCIARE

Përmbledhje Financiare	
Periudha e raportimit (data e parë dhe e fundit e periudhës që mbulon raportin)	01.01.2021 deri 31.12.2021
Shuma e parave në arkë në fillim dhe në fund të periudhës së raportimit (data e parë dhe e fundit e periudhës që mbulon raportin)	01.01.2021 – 0 leke    31.12.2021 – 0 leke
Shuma e përgjithshme e të gjithë kontributeve të marra	918,720
Shuma e përgjithshme e të gjitha shpenzimeve të bëra.	902,021
Bilanci në fund të periudhës së raportimit (data e fillimit dhe e përfundimit të periudhës që mbulon raportin)	01.01.2021-31.12.2021
Shuma e përgjithshme e të gjithë aktiveve në fund të periudhës së raportimit	16,699
Shuma e përgjithshme e të gjithë detyrimeve në fund të periudhës së raportimit.	0

#### a/ Audituesi Ligjor

- **Identiteti i audituesit ligjor**

- o Kush?

Silvana Gjikhima, Auditues Ligjor me Nr Licence 162 date 25.01.2007 leshuar nga IEKA

- o Çështja e mospërputhjeve të mundëshme.

Nuk ka

- **Përgjegjësi për përgatitjen dhe nënshkrimin e raportit vjetor.**



- o Nënshkrimi i raportit vjetor

Nënshkrimi i raportit vjetor është bërë nga kryefinancierja Znj. Liljana Mlloja

- o Paraqitja e të gjithë dokumenteve mbështetëse: vërejtja e problemeve të dukshme (shiko më poshtë)

a) bosh/mungon informacioni	Po / Jo	Çfarë?	
b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)			1,069,816
	<b>Të Ardhurat</b>		
		Financime publike	
		Donacione private	1,069,816
		Financim nga burimet e veta të partisë	
		Hua/Kredi	
	<b>Shpenzime</b>		1,053,117
		Shpenzimet e qerasë	35,000
		Stafi / rrogat	92,070
		Media	607,570
		Komunikimi	116,096
		Transporti	
		Shpenzimet bankare	5,500
		Administrative dhe të Përgjithshme	
		Amortizimi	





			Menaxhimi i Pronës	
			Shpenzime të tjera	196,881

**b/ Asetet/detyrimet dhe përmbledhjet financiare**

- Çdo mospërputhje / parregullsi në lidhje me deklarinimin e aktiveve dhe detyrimeve.

Nuk ka parregullsi ne lidhje me deklarinimin e aktiveve dhe detyrimeve.

- Defiçit/ shpenzime të papaguara

Nuk ka shpenzime te papaguara

**III. TË ARDHURAT**

**A. PËRMBLEDHJE**

		Sipas raportit vjetor	Sipas auditimit të kryer
<b>1/ Financimi publik</b>			
	Shuma e granteve publike të marra	<b>S'KA</b>	<b>S'KA</b>
	Data e tranfertës		
<b>2/ Donacionet private</b>			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	918,720	1,069,816
	Shuma e donacioneve në para	918,720	1,034,816



Shuma e donacioneve në natyrë	0	35,000
Paraqitja e një liste të donatorëve		PO
Paraqitja e të gjitha deklarimeve bankare		PO
Përputhshmëria mes çdo donacioni të raportuar dhe deklaramit bankar (shuma)		PO
Përputhshmëria mes çdo donacioni të raportuar dhe deklaramit bankar (data)		PO
Përputhshmëria mes çdo donacioni të raportuar dhe deklaramit bankar (donatori)		PO
Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)		PO
A përputhen shifrat e përgjithshme?		PO
Respektimi i kufirit të donacionit		PO
<b>3/ Financimi nga burimet e vetë partisë</b>		S'KA
Shuma e përgjithshme e raportuar		
Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)		
Kuotat e anëtarësisë		
Botimet		
Shtypshkronja		
Dhenie me qera		
Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)		
Kuotat e anëtarësisë		
Botimet		
Shtypshkronja		
Dhenie me qera		



	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe deklarimit bankar (shuma)		
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe deklarimit bankar (data)		
<b>4/ Huatë/Kreditë</b>			S'KA
	Shuma e përgjithshme e raportuar		
	Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)		
	Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)		
	Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua)		
<b>5/ Marrja e të ardhurave</b>			
	Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë përkatëse.	PO	po

**Kontributet e Specifikuara**

<b>Kriteret e kontributeve</b>	
Emri i kontribuesit	<b>Nuk ka kontribues</b>
Adresa e kontribuesit	
Profesioni i kontribuesit (nëse kontribuesit nuk ka profesion, shkruani "nuk ka profesion")	
Përshkrimi i kontributit (i tillë si "para në dorë" apo "çek" apo "transfertë bankare" apo "përshkrimi i kontributit në natyrë")	
Vlera e kontributit (për kontributet në natyrë shkruani vlerën e tregut, që është vlera e sendit nëse shitet në atë gjendje aktuale)	
Data kur është marrë kontributi	



## B. ANALIZA

### a/ Financimi nga burimet jo publike

#### - Donatorët e lejuar:

- o Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar;
- o Kontrolli i shumës së përgjithshme të donacioneve nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror dhe nga një degë e partisë;
- o Të paraqitet një listë e të gjithë donatorëve shuma e përgjithshme e të cilëve është më e madhe se 100,000 Lekë në raportin vjetor, së bashku me shumën e përgjithshme të dhuruar;
- o Të paraqitet shuma e donacioneve që kanë vlerën më pak se 100.000 Lekë, dhe shuma totale e këtyre donacioneve;

U verifikua identiteti i donatoreve , lejushmeria e cdo donacioni te deklaruar. U konstatua se jane plotesuar deklaratat per dhurimet per partite politike sipas nenit 23/1 te ligjit nr 8580 "Per partite politike" i ndryshuar. Eshte pasqyruar lista e personave, qe kane bere dhurime. Donacionet jane derdhur ne llogari bankare dhe perbejne shumen 1,069,816 leke.

**Burimet e palejuara      Nuk ka**

#### - Kontributet në natyrë

- o Vlerësimi:
  - Dallimi mes kontributit në natyrë (dhe mundësisht) financimit dhe veprimtarisë vullnetare
  - Vlerësimi (rregulli i 10% më të ulët se çmimi i tregut apo mallrave / shërbimeve që arrijnë vlerën më shumë se 50,000 Lekë) → kur partisë i ofrohen mallra apo shërbime falas në një çmim që është 10% më i ulët se çmimi i tregut, dallimi mes çmimit të tregut dhe pagesës së paguar nga partia duhet të pasqyrohet si donacion (së bashku me emrat e donatorëve nëse ky dallim e kalon shumën 100,000 Lekë).
  - Çmimi i tregut të mallrave dhe shërbimeve duhet të përcaktohet nga referenca e indeksit të çmimeve mujore të botuar nga INSTAT në kohën kur janë dhënë/ofruar mallrat/shërbimet. Në rast se indeksi nuk përfshin mallrat/shërbimet e ofruara, partia politike duhet të llogarisë çmimin e tregut duke u bazuar në mesataren e çmimeve të tre ofruesve të ndryshëm të mallrave/shërbimeve në kohën kur ato janë ofruar.



Kontributete ne natyre jane qera zyre me vlere totale 75,000 leke, vleresimi i te cilave eshte bere me vleren e tregut.

o **Kufizimet**

- Kontrolli i shumës së përgjithshme nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror nga një degë e partisë;
- Kufizimet (pragu i raportimit dhe deklarimit zbatohet si për kontributet në para ashtu edhe për ato në natyrë).

**b/ Financimi nga burimet e vetë partisë politike**

**Nuk ka financime nga burimet e vete partise.**

- **Klasifikimi me zëra i të ardhurave nga burimet e vetë partisë**

- o Kuotat e anëtarësisë: shuma e përgjithshme dhe ndarja e shumave të marra
- o Botimet
- o Shtypshkronjat
- o Marrja me qera.....

- **Klasifikimi në bazë të emrit të degës i të ardhurave që merren nga burimet e vetë partisë për secilin zë të deklaruar**

- o Zyra Qendrore
- o Degët lokale

- **Përputhshmëria mes natyrës së të ardhurave dhe shumës së deklaruar dhe deklarimit bankar**

**c/ Huatë/Kreditë Nuk ka hua**

**kredi te marra nga partia politike**

- Identiteti i huadhënësit/ve
- Shuma dhe data e huasë/ve (paraqitja e kontratës së kredisë / huasë).
- Data e shlyerjes e përcaktuar në kontratën e kredisë/huasë/ve (*problemi i huave të fshira- në rast dyshimi, e rëndësishme që të theksohet*)



- Normat e interesit

**IV. SHPENZIMET**  
**A.PËRMBLEDHJE**

Shpenzimet e bëra nga Zyra Qendrore e partisë							
	Shpenzimet e deklaruar në raportin vjetor	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumentet mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentat e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
<b>Shpenzimet e qerasë</b>	0						35,000
-Qiramarrja e ambienteve							
- Shërbimet komunale:							
-energji							
- uji							
- telefoni							
<b>Stafi/ rrogat</b>	92,070	92,070					92,070
<b>Media</b>	607,570	607,570					607,570
<b>Komunikimet</b>	0						116,096
- Botimet							
- Materialet promovuese							
-Sondazhet e opinionit publik/Konsulenca							



<b>Transporti</b>							
Automjetet me qera dhe karburanti							
Akomodimi							
Vaktet dhe shpenzime të paparashikuara							
<b>Shpenzimet bankare</b>	5,500	5,500					5,500
<b>Administrative dhe të përgjithshme</b>							
<b>Amortizim</b>							
<b>Menaxhim i Pronës</b>							
<b>Shpenzime të tjera</b>	196,881	196,881					196,881

**Nuk ka shpenzime per degjet e partise.**

<b>Të gjitha shpenzimet e kryera të paguara përmes një llogarie të veçantë</b>	Po
--	----

**A. ANALIZA**

**a/ Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruarra dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë:**



## **Nuk ka shpenzime per deget e partise.**

### **b/ Verifikimi**

- Risqet
- Risqet kryesore të auditimit në lidhje me shpenzimet e partisë janë se:
  - Shpenzimet deklarohen më të ulëta.

Ne shpenzimet vjetore te partise nuk jane perfshire dhurimet ne natyre per qerate e zyrave ne vleren 35,000 leke, si edhe shpenzimet ne rjetet sociale ne vleren 116,096 leke te bera gjate periudhes se fushates.

- Shpenzimet nuk shoqërohen nga një faturë e vërtetë

Te gjitha shpenzimet e kryera nga Partia gjate vitit 2021 jane kryer me fatura te regullta tatimore dhe jane likuiduar.

- Informacioni për shpenzimet e partisë përfshin jo vetëm aktivitetet e përditshme të partisë por gjithashtu edhe shpenzimet që kanë të bëjnë me një fushatë zgjedhore në vitet zgjedhore.

Ne shpenzimet vjetore te partise jane perfshire dhe shpenzimet e kryera gjate fushates zgjedhore, ne perjashtim te rastit te permendur me siper.

- Në mënyrë që të dokumentohen mirë financat e partisë politike nevojitet përdorimi i metodave standarde të auditimit. Në kontekstin e financave të partisë politike, metodat e mëposhtme janë shembuj i hartimit të metodave të tilla për specifikat e financave të partive politike:
  - Shqyrtoni një kategori të deklaruar të përzgjedhur të pagesave (për shembull për komunikimet) të krahasuar me dokumentacionin mbështetës/evidencat (faturat);

Kemi perzgjedhur disa pagesa per likuidimin e faturave dhe i kemi krahasuar me dokumentacionin mbeshtetes (faturat ) si me poshte:





Pagesat		Fatura		
Banka	Data	Vlera		Vlera
BKT leke	13.04.2021	92145	Bluberis production nr 15773225	92145
BKT leke	06.12.2021	30000	Hydajete Kraja Nr 46/2021	30000
BKT leke	08.10.2021	16391	Taksa bashkie	16391

- Raportimi i shpenzimeve në natyrë. Duhet të ketë një përputhje me donacionet në natyrë.

Partia nuk ka përfshirë në shpenzimet vjetore shpenzimet në natyrë për qerata e zyrave në periudhën e fushatës. Po ashtu nuk ka përfshirë dhe donacionet në natyrë.

## **V. PËRFUNDIMI**

### **A. SINTEZA**

a. Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve.

1-Partia Levizja për Ndryshim ushtron aktivitetin e saj në përputhje me Ligjin për Partitë Politike Nr.8580 datë 17/02/2000 i ndryshuar, si dhe me statutin e saj.

2- Mban kontabilitetin në përputhje me Standartet e Kontabilitetit që janë të zbatueshme në Shqipëri e sipas Standardit Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat jo Fitimprurëse (SKK për OJF-të).

3-Partia punon me llogari bankare.

Shuma e gjendjes së llogarive bankare sipas bank statement në 31 Dhjetor 2021 përputhet me shumën e raportuar nga partia në raportin vjetor.

4- Partia nuk ka asete në pronësi të saj me 31.12.2021

5- Nuk ka detyrime me 31.12.2021



6-Te ardhurat perbehen nga donacionet private ne masen 1,069,816 leke

b. Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të auditimit.

1. Partia " Levizja për Ndryshim " nuk ka paraqitur te ardhura dhe shpenzime per deget e saj.

2. Ne te ardhurat nuk jane pasqyrurar donacinet ne natyre per qerate e zyrove ne masen 35,000 leke si edhe donacinet ne para ne vleren 116,096 leke te kryera ne rjetet sociale, face book.

3. Vlerat e mesiperme nuk jane perfshire dhe ne Shpenzimet vjetore te partise.

## **B. PËRFUNDIMI**

Opinionimi me permiresime

Ne kemi kemi audituar pasqyrat financiare te Partise Levizja per Ndryshim ,të cilat përbehen nga bilanci kontabël i dates 31 Dhjetor 2021 pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe pasqyra e flukseve të parave për vitin qe mbyllet ne kete date, si dhe shenimet per pasqyrat financiare, perfshire nje permbledhje te politikave kontabel me te rendesishme.

Sipas opinionit tonë , me perjashtim te pa regullsive te gjetura me siper pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Partise Levizja per Ndryshim me 31 Dhjetor 2021,të rezultatit të saj financiare dhe të flukseve të parave te saj për vitin e mbyllur financiare me 31.12.2021, në përputhje me kuadrin financiar te raportimit te partive politike.

Audituese ligjore

Silvana Gjikhima

Adresa : Rr Besnik Sykja, Nd.13, H.4, Ap.5

SILVA GJIKHIMA  
E/K A LICENSA NR 162  
NIPT 32202008F

Tirane me,23.05.2022

